URDHËR
Nr. 2, datë 9.1.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Bazuar në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 13, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, në nenin 7, të rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, si dhe në nenin 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për procedurat e prokurimit publik, te znj. Alketa Çeli, Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo